




Electrolux




electrolux.com/register




ERA7DE18C

INSTALIMI / INSTALACJA



ZHURMA / DŹWIĘKI



Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. INFORMACIONI I SIGURISË.....	3
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË.....	5
3. PANELI I KONTROLLIT.....	7
4. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....	8
5. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....	10
6. KUJDESI DHE PASTRIMI.....	11

7. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....	11
8. TË DHËNAT TEKNIKE.....	14
9. INFORMACION PËR INSTITUTET E TESTIMIT.....	14
10. SHQETËSIME MJEDISORE.....	15

1. ⚠ INFORMACIONI I SIGURISË

Përpara instalimit dhe përdorimit të kësaj pajisjeje, lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna. Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të pasaktë. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave vulnerabël

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit. Fëmijët e moshës nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi shumë të mëdha dhe

komplekse të kufizuara lejohen të ngarkojnë dhe shkarkojnë pajisjen me kusht që të jenë udhëzuar siç duhet. Fëmijët më të vegjël se 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.

- Fëmijët duhet të mbikëqyren për t'u siguruar se nuk luajnë me pajisjen.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.
- Mbajeni të gjithë paketimin larg nga fëmijët dhe hidheni atë siç kërkohet.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Kjo pajisje përdoret vetëm për mbajtjen e ushqimeve dhe të pijeve.
- Kjo pajisje është krijuar për përdorim shtëpiak në ambient të brendshëm.

- Kjo paisje mund të përdoret në: zyra, dhoma hoteli, dhoma bujtine, dhoma hoteli rural, si dhe në vende të ngjashme ku përdorimi nuk tejkalon (mesatarisht) nivelet e përdorimit shtëpiak.
- Për të shmangur kontaminimin e ushqimit, respektoni udhëzimet e mëposhtme:
 - mos e hapni derën për periudha të gjata;
 - pastroni rregullisht sipërfaqet që mund të bien në kontakt me ushqimin dhe sistemet e aksesueshme të shkarkimit;
 - ruajeni mishin e pagatuar dhe peshkun në enë të përshtatshme në frigorifer, që të mos bien në kontakt me ushqimet e tjera ose të mos pikojnë mbi ushqimet e tjera.
- PARALAJMËRIM: Mbajini pa pangesa vrimat e ajrimit në kasën e pajisjes ose në strukturën inkaso.
- PARALAJMËRIM: Mos përdorni pajisje mekanike apo mjete të tjera për të përshpejtuar procesin e shkrirjes, përveç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.
- PARALAJMËRIM: Mos e dëmtoni qarkun e ftohësit.
- PARALAJMËRIM: Mos përdorni pajisje elektrike brenda ndarëseve të ruajtjes së ushqimeve të pajisjes, përveç nëse janë lloji i rekomanduar nga prodhuesi.
- Mos përdorni spërkatësin e ujit dhe avullin për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me copë të butë e të njomë. Përdorni vetëm detergjentë neutralë. Mos përdorni produkte gërryese, materiale të ashpra pastruese, tretës ose objekte metalike.
- Kur pajisja lihet bosh për periudha të gjata kohe, fikeni, shkrijeni, pastrojeni, thajeni dhe lëreni derën të hapur për të mos lejuar zhvillimin e mykut brenda pajisjes.
- Mos mbani substanca shpërthyes si kanaçe aerosoli me lëndë djegëse të ndezshme në këtë pajisje.
- Për të shmangur rreziqet, nëse kordoni elektrik është e dëmtuar, duhet zëvendësuar nga prodhuesi, qendra e

autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi

PARALAJMËRIM!

Vetëm një person i kualifikuar duhet ta instalojë këtë pajisje.

- Hiqni të gjithë paketimin.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Mos e përdorni pajisjen përpara se ta instaloni në strukturën inkaso për arsye sigurie.
- Ndiqui udhëzimet e veçanta për instalimin e pajisjes dhe ndërrimin e kahut të derës në dispozicion në faqen tonë ueb.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Sigurohuni që ajri të mund të qarkullojë rreth pajisjes.
- Pas instalimit të parë ose pas ndryshimit të kahut të derës, prisni të paktën 4 orë përpara se ta lidhni pajisjen me energjinë elektrike. Kjo bëhet për të lejuar që vaji të rrjedhë përsëri në kompresor.
- Përpara se të kryeni ndonjë lloj veprimi në pajisje (p.sh. ndryshimi i kahut të derës), hiqni spinën nga priza e energjisë.
- Mos e instaloni pajisjen pranë radiatorëve apo sobave, furrave apo pianurave, përveç kur specifikohet ndryshe në udhëzimet e instalimit.
- Mos e ekspozoni pajisjen ndaj shiut.
- Mos e instaloni pajisjen atje ku ka dritë të drejtpërdrejtë dielli.
- Mos e instaloni këtë pajisje në zona që kanë shumë lagështirë ose që janë shumë të ftohta.
- Kur e lëvizni pajisjen, ngrijeni nga buza e përparme për të shmangur gërvishtjen e dyshemesë.
- Mbroni dyshemenë nga gërvishtjet kur ndërroni krahun derën e pajisjes.
- Pajisja përmban një qese me absorbues lagështire. Ajo nuk është lodër. Nuk është ushqim. Hidheni atë menjëherë.

2.2 Lidhja elektrike

PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

PARALAJMËRIM!

Kur poziciononi pajisjen, sigurohuni që kordoni i energjisë të mos ngecë ose dëmtohet.

PARALAJMËRIM!

Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kablo zgjatuese.

KUJDES!

Çdo ndërhyrje elektrike e nevojshme për të instaluar këtë pajisje duhet të kryhet nga një elektrikist i kualifikuar.

- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.
- Pajisja duhet të lidhet me tokëzimin.
- Përdorni gjithmonë një prizë me tokëzim të instaluar mirë.
- Nëse priza e linjës elektrike e shtëpisë s'është e tokëzuar, lidheni pajisjen me një tokëzim të veçantë në përputhje me rregulloret aktuale, duke u konsultuar me një elektrikist të kualifikuar.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni elementët përbërës elektrikë (p.sh. spinën e rrjetit, kablloën e rrjetit, kompresorin). Kontaktoni Qendrën e autorizuar të shërbimit ose një elektrikist për të ndryshuar elementët përbërës elektrikë.
- Kabloja e rrjetit duhet të qëndrojë nën nivelin e spinës.
- Futni spinën në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që rrjeti elektrik të jetë i arritshëm pas instalimit.
- Mos e shkëputni pajisjen duke tërhequr kablloën elektrike. Tërhiqeni gjithmonë nga spina.
- Kjo pajisje vjen me një spinë elektrike 13 A. Nëse është e nevojshme të ndërroni siguresën e spinës kryesore, përdorni

vetëm siguresë 13 A ASTA (BS 1362)
(vetëm në MB dhe Irlandë).

2.3 Përdorimi

PARALAJMËRIM!

Rrezik lëndimi, djegiesh, goditjeje
elektrike ose zjarri.



Pajisja përmban gaz të ndezshëm, izobutan (R600a), një gaz natyror me nivel të lartë pajtueshmërie me mjedisin. Bëni kujdes të mos shkaktoni dëmtime te qarku i agjentit ftohës që përmban izobutan.

- Mos i ndryshoni specifikimet e pajisjes.
- Ndalohet rreptësisht çdo përdorim i produktit inkaso më vete.
- Kjo pajisje është synuar për t'u përdorur në temperaturën e ambientit që shkon nga 10°C deri në 38°C. Diapazoni i specifikuar i temperaturës garanton funksionimin e duhur të pajisjes.
- Mos vendosni pajisje elektrike (p.sh. prodhues të akulloreve) në pajisje përveç nëse ato deklarohen të përdorshme nga prodhuesi.
- Nëse ndodh dëmtim i qarkut të ftohësit, sigurohuni që të mos ketë flakë dhe burime të ndezjes në dhomë. Ventiloni dhomën.
- Mos lejoni që objektet e nxehta të prekin pjesët plastike të pajisjes.
- Mos mbani gaz dhe lëng të ndezshëm në pajisje.
- Mos vendosni produkte që marrin flakë ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë pajisjes ose mbi të.
- Mos e prekni kompresorin ose kondensatorin. Janë të nxehtë.
- Mos lejoni që ushqimi të bjerë në kontakt me sipërfaqet e brendshme të ndarjeve të pajisjes.

2.4 Ndriçimi i brendshëm

PARALAJMËRIM!

Rrezik goditjeje elektrike.

- Ky produkt përmban një apo më shumë burime drite të kategorisë të efikasitetit të energjisë F.
- Në lidhje me llambat brenda produktit dhe llambat e pjesëve të këmbimit të shitura veçmas: Këto llamba janë prodhuar për kushte ekstreme fizike në pajisjet elektroshtëpiake, si p.sh. temperaturë,

dridhje, lagështirë, ose janë prodhuar për të sinjalizuar informacion rreth statusit të përdorimit të pajisjes. Ato nuk janë prodhuar për t'u përdorur në aplikacione të tjera dhe nuk janë të përshtatshme për ndriçim në ambiente shtëpiake.

2.5 Kujdesi dhe pastrimi

PARALAJMËRIM!

Rrezik plagosjeje ose dëmtim i pajisjes.

- Përpara mirëmbajtjes, çaktivizoni pajisjen dhe hiqeni spinën nga priza.
- Kjo pajisje përmban hidrokarbure në njësinë e ftohjes. Mirëmbajtja dhe rimbushja i njësisë duhet të bëhet vetëm nga një person i kualifikuar.
- Kontrolloni produktin rregullisht për shenja përkeqësimi që mund ta bëjnë të papërshtatshëm për kontakt me ushqimin, si p.sh. çarje, fluska, delaminim, tkurrje, ngjitje, korrozion ose ndryshime të tjera të dukshme në strukturë ose pamje. Ndiqui udhëzimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes për të parandaluar përkeqësimin.
- Ekzaminoni rregullisht shkarkuesin e pajisjes dhe nëse është e nevojshme pastrojeni. Nëse shkarkuesi është i bllokuar, uji i shkrirë mbliidhet në fund të pajisjes.

2.6 Shërbimi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me qendrën e autorizuar të shërbimit. Përdorni vetëm pjesë rezervë origjinale.
- Ju lutemi vini re se vetëriparimi ose riparimi joprofesional mund të ketë pasoja sigurie dhe mund të zhvlerësojë garancinë.
- Pjesët e mëposhtme rezervë janë të disponueshme për të paktën 7 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit: termostetet, sensorët e temperaturës, qarqet, burimet e dritës, dorezat e dyerve, menteshat e dyerve, vasketat dhe koshat. Guarnicionet e dyerve janë të disponueshme për të paktën 10 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit. Afati mund të jetë më i gjatë në vendin tuaj. Për informacion të mëtejshëm, vizitoni faqen tonë të internetit.
- Ju lutemi vini re se disa nga këto pjesë këmbimi janë të disponueshme vetëm për riparuesit profesionistë, dhe se jo të gjitha pjesët e këmbimit u përshtaten të gjitha modeleve.

2.7 Hedhja e mbeturinave


⚠ PARALAJMËRIM!

Rreziku i lëndimit ose mbytjes.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit elektrik.
- Prisni kabllon e lidhjes me rrjetin dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar bllokimin brenda pajisjes të fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake.

- Qarku i ftohjes dhe materialet e izolimit të kësaj pajisjeje nuk ndikojnë tek ozoni.
- Shkuma izoluese përmban gaz të ndezshëm. Kontaktoni autoritetin e bashkisë suaj për t'u informuar mbi mënyrën e duhur të hedhjes së pajisjes.
- Mos i shkaktoni dëmtime pjesës së njësive të ftohjes që është afër shkëmbyesit të nxehtësisë.

3. PANELI I KONTROLLIT



1. Butoni i temperaturës
2. Tregues të temperaturës
3. Butoni Mode / Butoni i NDEZUR/FIKUR së pajisjes
4. Treguesi AI CoolAssist
5. Treguesi Extra Cool

3.1 Ndezja/fikja

Ndezja

1. Futni spinën në prizën e korrentit.
2. Shtypni e mbani butonin e NDEZUR/FIKUR. Treguesit e temperaturës çaktivizohen.

Treguesit e temperaturës tregojnë temperaturën e parazgjedhur.

Fikja e pajisjes

1. Shtypni e mbani shtypur butonin e NDEZUR/FIKUR. Treguesit e temperaturës çaktivizohen.
2. Hiqeni pajisjen nga priza.

3.2 Rregullimi i temperaturës

❗ S'është e mundur të vendosni temperaturën kur funksioni Extra Cool është i aktivizuar.

❗ S'është e mundur të vendosni temperaturën kur funksioni AI CoolAssist është i aktivizuar.

Cilësoni temperaturën e pajisjes duke shtypur butonin e temperaturës.

Treguesit e temperaturës tregojnë nivelin e caktuar të temperaturës.

Sfera e temperaturës mund të ndryshojë ndërmjet 2°C dhe 8°C (e rekomanduar 4°C).

❗ Temperatura e cilësuar do të arrihet brenda 24 o.
Pas një ndërprerje të energjisë, pajisja kthen temperaturat e vendosura.

3.3 AI CoolAssist

AI CoolAssist është një veçori e mundësuar nga të mësuarit e makinerive që rregullon cilësimet e pajisjes bazuar në modelet individuale të përdorimit, duke përfshirë frekuencën e hapjes së derës dhe ndërveprimet e tjera të përdoruesit me pajisjen. Kur aktivizohet, AI CoolAssist mundëson regjimet inteligjente të mëposhtme:

- menaxhimin e temperaturës: rregullon automatikisht temperaturën në ndarjet e frigoriferit dhe ngjirjes për të siguruar ruajtjen optimale të ushqimit.
- Auto Shopping Mode: rregullon automatikisht cilësimet e temperaturës në ndarjen e frigoriferit pas blerjeve të ushqimeve për të ftohur shpejt artikujt e shtuar rishtas. Ky modalitet aktivizohet automatikisht kur AI CoolAssist është ndezur.
- Auto Vacation Mode: zvogëlon konsumin e energjisë kur pajisja nuk është në përdorim për tre ose më shumë ditë

rresht. Ky modalitet aktivizohet automatikisht kur AI CoolAssist është ndezur.

Për ta aktivizuar/çaktivizuar funksionin, shtypni butonin Mode.

Kur funksioni është i aktivizuar AUTO treguesi ndizet ndërsa treguesit e tjerë fiken.

Për t'u kthyer te cilësimet manuale, shtypni butonin Mode derisa treguesi i temperaturës të ndizet.

❗ Butoni i rregullimit të temperaturës është i çaktivizuar kur AI CoolAssist është i aktivizuar. Fikeni për të rregulluar temperaturën.

❗ Aktivizimi i AI CoolAssist, ndërsa Extra Cool dhe/ose Extra Freeze janë ndezur, çaktivizon Extra Cool dhe Extra Freeze. Aktivizimi i Extra Cool dhe/ose Extra Freeze, ndërsa AI CoolAssist është ndezur, çaktivizon AI CoolAssist.

3.4 Extra Cool funksioni

Funksioni Extra Cool ju lejon të ftohni shpejt sasi të mëdha të ushqimit të ngrohtë pa ngrohur ushqimin e ruajtur tashmë në ndarjen e frigoriferit.

Për ta aktivizuar/çaktivizuar funksionin Extra Cool shtypni butonin Mode derisa treguesi Extra Cool të ndizet/fiket.

❗ Ky funksion ndalon pas afërsisht 6 o.

3.5 Alarmi i hapjes së derës

Nëse dera e frigoriferit lihet hapur për afërsisht 5 min, treguesit e temperaturës së frigoriferit pulson dhe aktivizohet tingulli.

Shtypni ndonjë buton për të fikur tingullin. Tingulli çaktivizohet pas 1 o.

Alarmi çaktivizohet pas mbylljes së derës.


4. PËRDORIMI I PËRDITSHËM

⚠ KUJDES!

Kjo pajisje frigoriferike nuk është e përshtatshme për ngrijen e ushqimeve.


4.1 Vendosja e rafteve të derës

Për ruajtje më të lehtë të ushqimit, sirtarët e derës mund të vendosen në lartësi të ndryshme. Nxirreni sirtarin për ta ripozicionuar.



4.2 Raftet lëvizëse


Paretet e frigoriferit janë të pajisura me shina. Mund të ndryshoni pozicionin e rafteve.




❗ Mos e hiqni raftin prej xhami mbi sirtarin e zarzavateve për të siguruar qarkullimin e saktë të ajrit.

4.3 Heqja e ExtraZone

1. Mbajeni sirtarin bashkë me kapakun prej xhami të ExtraZone dhe tërhiqini drejt vetes.



2. Anojeni moduln për poshtë për ta hequr nga frigoriferi.




4.4 Sirtari i zarzavateve


Sirtari është i përshtatshëm për ruajtjen e frutave dhe të zarzavateve.

Për të hequr sirtarin:

1. Nxirni sirtarin dhe ngrijeni.




2. Shtyjini shinat brenda në dollap.




Për ta rimontuar:

1. Tërhiqni shinat.



2. Vendosni pjesën e pasme të sirtarit (1) në shina.




3. Mbajeni pjesën e përparme të sirtarit (2) të ngritur ndërkohë që shtyni sirtarin brenda.
4. Shtypni pjesën e përparme të sirtarit poshtë.
5. Nxirreni sirtarin përsëri dhe kontrolloni nëse është vendosur saktë në të dy grepat, si para dhe prapa.

4.5 Treguesi i temperaturës

Ka një tregues të temperaturës në paretin anësor të pajisjes. Simboli tregon pjesën më të ftohtë në frigorifer.


Nëse OK është shfaqur (A), vendosni ushqim të freskët në pjesën e treguar nga simboli. Nëse jo (B), prisni të paktën 12 orë dhe kontrolloni përsëri.

Nëse nuk është ende OK (B), cilësoni një temperaturë më të ftohtë.



4.6 Ventilator

Ndarja e frigoriferit është e pajisur me një ventilator që lejon ftohjen e shpejtë të ushqimeve dhe ruan një temperaturë të njëtrajtshme në të.



Ventilatori aktivizohet automatikisht kur nevojitet.


i Ventilatori funksionon vetëm kur dera është e mbyllur.

i Mos e hiqni kapakun e ventilatorit.

4.7 Rafti i shisheve

Vendosini shishet (me grykën përpara) në raftin e pozicionuar paraprkisht.

i Vendosni vetëm shishe të mbyllura në raft.



5. UDHËZIME DHE KËSHILLA

5.1 Si të kursejmë energjinë

- Konfigurimi me sirtarët në pjesën e poshtme të pajisjes dhe raftet të shpërndarë në mënyrë të barabartë siguron përdorimin më të efektshëm të energjisë. Pozicioni i koshëve të dyerve nuk ndikon në konsumin e energjisë.
- Mos e hapni shpesh derën ose mos e lini hapur për një kohë më të gjatë sesa nevojitet.
- Mos e vendosni temperaturën shumë të lartë, përveç rastit kur këtë gjë e kërkojnë karakteristikat e ushqimit.
- Nëse temperatura e ambientit është e lartë, rregullatori i temperaturës është caktuar të japë temperaturë të ulët dhe pajisja është e mbushur plot, kompresori mund të punojë pa ndërprerje duke shkaktuar formimin e brymës ose akullit në aparatin e avullimit. Në këtë rast, vendoseni rregullatorin e temperaturës në një temperaturë më të lartë për të lejuar shkrijen automatike.
- Mos i mbulonit rrjetën ose vrimat e ventilimit.

5.2 Si të mbajmë ushqimet në frigorifer

i Ndarja e ushqimeve të freskëta është e shënuar (në pllakën e vlerësimit) me .

- Cilësimi i mirë i temperaturës që garanton ruajtjen e ushqimit të freskët është temperatura më pak ose e barabartë me +4°C.
- Gjithmonë përdorni enë të mbyllura për lëngjet dhe ushqimin, për të shmangur daljen e aromave ose shijeve në ndarje.
- Për të shmangur kontaminimin mes ushqimit të gatuar dhe të pagatuar, mbulojini ushqimet e gatua dhe ndajini ato nga ato të pagatuarat.
- Mbështilleni dhe vendoseni mishin në raftin e xhamit që ndodhet mbi sirtarin e zarzavateve.
- Shkrijeni ushqimin brenda frigoriferit.
- Mos vendosni ushqim të nxehtë brenda në pajisje.
- Pastroni frutat dhe zarzavatet dhe vendosini në një sirtar të përkushtuar (sitari i zarzavateve).
- Mos mbani fruta ekzotike në frigorifer.
- Mos mbani zarzavate si domate, patate, qepë dhe hudhra në frigorifer.
- Mbyllini shishet përpara sesa t'i futni në frigorifer.

6. KUJDESI DHE PASTRIMI

⚠ PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve të sigurisë.

6.1 Pastrimi i pjesës së brendshme

Përpara përdorimit të parë, pastroni pjesën e brendshme dhe të gjithë aksesorët me ujë të vakët dhe sapun neutral, pastaj thajini.

⚠ KUJDESI!

Aksesorët dhe pjesët e pajisjes nuk janë të përshtatshme për larje në lavastovilje.

⚠ KUJDESI!

Pastroni panelin e kontrollit me një copë të njomë. Mos përdorni ndonjë detergjent. Thajeni panelin e kontrollit me një leckë të butë.

6.2 Pastrimi periodik

Pastroni pajisjen rregullisht:

- Pastroni pjesën e brendshme dhe aksesorët me ujë të vakët dhe sapun neutral. Shpëlajini dhe thajini.
- Fshini guarnicionet e dyerve rregullisht.


6.3 Shkrija e ngrirësit

Bryma eliminohet automatikisht nga avulluesi i ndarjes së ngrirësit gjatë përdorimit normal.

Uji i shkrires derdhet përmes një zgavre në një enë të veçantë ku avullon.

Pastroni rregullisht vrimën e kullimit të ujit të shkrires në mes të kanalit të ndarjes së frigoriferit.

Përdorni pastruesin e tubave të dhënë me pajisjen.



6.4 Periudha e mospërdorimit

Kur pajisja nuk përdoret për një periudhë të gjatë, merrni masat paraprake të mëposhtme:

1. Shkëputeni pajisjen nga furnizimi me elektricitet.
2. Hiqni të gjithë ushqimin.
3. Pastroni pajisjen dhe të gjithë aksesorët.
4. Lëreni derën paksa hapur për të shmangur formimin e erërave të pakëndshme.

7. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

⚠ PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve të sigurisë.

7.1 Çfarë duhet bërë nëse...

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja nuk punon.	Pajisja është e fukur.	Ndizni pajisjen.
	Spina e pajisjes nuk është lidhur siç duhet me prizën e rrjetit.	Futeni në prizë siç duhet spinën e pajisjes.
	Nuk ka tension në prizën e rrjetit.	Lidhni një pajisje tjetër elektrike në prizën e rrjetit. Kontaktoni një elektrikist të kualifikuar.
Pajisja është e zhurmshme.	Pajisja nuk mbështetet siç duhet.	Kontrolloni nëse pajisja qëndron e fiksuar.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Është aktiv alarmi akustik ose vizual.	Dera është lënë hapur.	Mbyllni derën.
Kompresori punon vazhdimisht.	Temperatura është vendosur gabim.	Referojuni kapitullit "Paneli i kontrollit".
	Shumë ushqim është vendosur në të njëjtën kohë.	Prisni disa orë e më pas kontrolloni sërish temperaturën.
	Temperatura e dhomës është shumë e lartë.	Referojuni kapitullit "Instalimi".
	Ushqimi i futur në pajisje është shumë i ngrohtë.	Lëreni ushqimin të ftohet në temperaturën e dhomës përpara se ta ruani.
	Dera nuk është mbyllur siç duhet.	Referojuni seksionit "Mbyllja e derës".
	Funksioni Extra Cool është i aktivizuar.	Shikoni seksionin "Funksioni Extra Cool".
Kompresori nuk fillon menjëherë pas shtypjes së "Extra Cool", ose pas ndryshimit të temperaturës.	Kompresori ndizet pas një periudhe kohore.	Kjo është normale, nuk ka ndodhur asnjë gabim.
Dera është e pakalibruar ose pengon skarën e ventilimit.	Pajisja nuk është e niveluar.	Shikoni udhëzimet e instalimit.
Dera nuk hapet lehtë.	Jeni përpjekur të rihapni derën menjëherë pas mbylljes.	Prisni pak sekonda mbas mbylljes dhe rihapjes së derës.
Llamba nuk punon.	Llamba është në gjendje gatishmërie.	Mbyllni dhe hapni derën.
	Llamba është me defekt.	Kontakttoni qendrën e shërbimit të autorizuar.
Ka shumë brymë dhe akull.	Dera nuk është mbyllur siç duhet.	Referojuni seksionit "Mbyllja e derës".
	Guarnicioni është i deformuar ose i ndotur.	Referojuni seksionit "Mbyllja e derës".
	Ushqimi nuk është mbështjellë siç duhet.	Mbështillenë ushqimin siç duhet.
	Temperatura është vendosur gabim.	Referojuni kapitullit "Paneli i kontrollit".
	Pajisja është mbushur plotësisht dhe është vendosur në temperaturën më të ulët.	Vendosni një temperaturë më të lartë. Referojuni kapitullit "Paneli i kontrollit".
	Temperatura e vendosur në pajisje është tepër e ulët dhe temperatura e ambientit është tepër e lartë.	Vendosni një temperaturë më të lartë. Referojuni kapitullit "Paneli i kontrollit".
Uji rrjedh në pllakën e pasme të frigoriferit.	Gjatë procesit automatik të shkrirjes së akullit, bryma shkrirhet në pllakën e pasme.	Kjo është e saktë.
Ka shumë ujë të kondensuar brenda frigoriferit.	Dera është hapur shumë shpesh.	Hapeni derën vetëm kur është e nevojshme.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
	Dera nuk është mbyllur plotësisht.	Sigurohuni që dera të jetë mbyllur plotësisht.
	Ushqimi i ruajtur nuk është mbështjellë.	Mbështilleni ushqimin në paketime të përshtatshme përpara se ta ruani në pajisje.
	Kjo është normale që gjatë verës dhe vjeshtës më shumë kondensim mund të formohet për shkak të rritjes së lagështirës së ajrit dhe ushqimit. Frigoriferi nuk prodhon ndonjë lagështirë. Pas kësaj periudhe, lagështira në frigorifer pakësohet vetë.	Në verë dhe vjeshtë, vendosni temperaturën më të ngrohtë në frigorifer (afërsisht 6-7°C).
Ka pika uji në raftet e xhamit.	Ka shumë lagështirë brenda frigoriferit.	Fshini raftet e xhamit me një copë për të hequr pikat e ujit.
Ujë rrjedh brenda frigoriferit.	Ushqimi pengon ujin nga rrjedhja në mbledhësin e ujit.	Sigurohuni se ushqimi nuk prek pllakën e pasme.
	Shkarkuesi i ujit është bllokuar.	Pastroni shkarkuesin e ujit.
Temperatura nuk mund të caktohet.	Është aktivizuar Extra Cool funksioni.	Çaktivizoni Extra Cool funksionin me dorë ose prisni derisa funksioni të çaktivizohet automatikisht. Shikoni seksionin "Extra Cool funksioni"
Temperatura në pajisje është tepër e ulët/e lartë.	Temperatura nuk është vendosur siç duhet.	Vendosni një temperaturë më të lartë/më të ulët.
	Dera nuk është mbyllur siç duhet.	Referojuni seksionit "Mbyllja e derës".
	Ushqimi është shumë i nxehtë.	Lejoni që ushqimi të ftohet përpara ruajtjes.
	Mos ushqim është ruajtur në të njëjtën kohë.	Ruani më pak ushqim në të njëjtën kohë.
	Dera është hapur shumë shpesh.	Hapeni derën vetëm nëse është e nevojshme.
	Funksioni Extra Cool është i aktivizuar.	Referojuni seksionit "Extra Cool funksion".
	Nuk ka qarkullim të ajrit të ftohtë në pajisje.	Siguroni qarkullim të ajrit të ftohtë në pajisje. Referojuni kapitullit "Udhëzime dhe këshilla".

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Vezullon treguesi i pestë i temperaturës.	Problem komunikimi.	Kontaktoni qendrën e shërbimit të autorizuar. Sistemi i ftohjes do të vazhdojë ta mbajë ushqimin të ftohtë, por rregullimi i temperaturës nuk do të jetë i mundur.
Vezullon treguesi i parë ose i dytë i temperaturës.	Problem i sensorit të temperaturës.	Kontaktoni qendrën e shërbimit të autorizuar. Sistemi i ftohjes do të vazhdojë ta mbajë ushqimin të ftohtë, por rregullimi i temperaturës nuk do të jetë i mundur.

❗ Nëse problemi vazhdon, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

7.2 Ndërrimi i llambës

Për zëvendësimin e llambës, kontakti Qendrën e shërbimit të autorizuar.

7.3 Mbyllja e derës

1. Pastroni guarnicionet e derës.

2. Për të rregulluar derën, referojuni udhëzimeve të instalimit.
3. Për të zëvendësuar unazat me të meta të dyerve, kontakti qendrën e shërbimit të autorizuar.

8. TË DHËNAT TEKNIKE

Informacioni teknik është në etiketën e energjisë dhe në pllakën e të dhënave të pajisjes, e cila mund të jetë e vendosur në pajisje ose brenda saj.

Vetëm për Zvicrën

Tensioni: 220-240 V

Frekuenca: 50 Hz

Vetëm për BE-në

Kodi QR në etiketën e energjisë të dhënë me pajisjen jep një lidhje interneti tek informacioni që lidhet me performancën e pajisjes në databazën e EU EPREL. Ruajeni etiketën e energjisë për referencë së bashku me manualin e përdorimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që ofrohen me këtë

pajisje. Të njëjtin informacion mund ta gjeni gjithashtu në EPREL duke përdorur lidhjen <https://eprel.ec.europa.eu>, si dhe emrin e modelit dhe numrin e produktit që gjeni në pllakën e specifikimeve të pajisjes. Shikoni lidhjen www.theenergylabel.eu për informacion të detajuar rreth etiketës së energjisë.

Vetëm për MB-në

Kodi QR në etiketën e energjisë të dhënë me pajisjen jep një lidhje interneti tek informacioni që lidhet me performancën e pajisjes. Ruajeni etiketën e energjisë për referencë së bashku me manualin e përdorimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që ofrohen me këtë pajisje.

9. INFORMACION PËR INSTITUTET E TESTIMIT

Instalimi dhe përgatitja e pajisjes për çfarëdo verifikimi të EcoDesign duhet të jetë në përputhje me:

UK	BS EN 62552
BE, Zvicër, Izrael	EN 62552

Australi	IEC 62552
Afrikë e Jugut	SANS 62552
EBA	UAE.S 5010-3:2022
GCC	SASO-2892_2018

Kërkesat për ventilimin, dimensionet e zgavrës dhe hapësirat minimale të pasme duhet të jenë siç përcaktohet në këtë "Manual

përdorimi" të "Instalimi". Kontaktoni me prodhuesin për çdo informacion tjetër të mëtejshëm, duke përfshirë planet e ngarkimit.

10. SHQETËSIME MJEDISORE

Ricikloni materialet me simbolin . Vendoseni paketimin në kutitë përkatëse për ta ricikluar. Ndiemoni në mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut duke ricikluar mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe

elektronike. Mos i hidhni pajisjet e shënuara me simbolin  me mbeturinat shtëpiake. Kthejeni produktin në qendrën tuaj lokale të riciklimit ose kontaktoni zyrën tuaj komunale..

1. INFORMACJE DOTYCZĄCE BEZPIECZEŃSTWA.....	16	6. KONSERWACJA I CZYSZCZENIE.....	24
2. INSTRUKCJE DOTYCZĄCE BEZPIECZEŃSTWA.....	18	7. ROZWIĄZYWANIE PROBLEMÓW.....	25
3. PANEL STEROWANIA.....	20	8. DANE TECHNICZNE.....	27
4. CODZIENNE UŻYTKOWANIE.....	21	9. INFORMACJA DLA INSTYTUCJI WYKONUJĄCYCH TESTY.....	28
5. WSKAZÓWKI I PORADY.....	23	10. OCHRONA ŚRODOWISKA.....	28

1. INFORMACJE DOTYCZĄCE BEZPIECZEŃSTWA

Przed instalacją i użyciem urządzenia należy dokładnie przeczytać dołączoną instrukcję. Producent nie odpowiada za obrażenia ani szkody wynikające z nieprawidłowej instalacji lub użytkowania. Instrukcję należy przechowywać w bezpiecznym i łatwo dostępnym miejscu do wykorzystania w przyszłości.

1.1 Bezpieczeństwo dzieci i osób o ograniczonych zdolnościach ruchowych

- Urządzenie mogą obsługiwać dzieci po ukończeniu ósmego roku życia oraz osoby o ograniczonych zdolnościach fizycznych, sensorycznych lub umysłowych, a także nieposiadające odpowiedniej wiedzy lub doświadczenia, jeśli będą one nadzorowane lub zos-

taną poinstruowane w zakresie bezpiecznego korzystania z urządzenia i będą świadome związanych z tym zagrożeń. Dzieci w wieku od 3 do 8 lat oraz osoby z bardzo rozległą i złożoną niepełnosprawnością mogą ładować i opróżniać urządzenie pod warunkiem, że zostały odpowiednio poinstruowane. Dzieci poniżej 3 roku życia nie powinny zbliżać się do urządzenia, jeśli nie znajdują się pod stałym nadzorem.

- Należy dopilnować, aby dzieci nie bawiły się tym urządzeniem.
- Dzieci nie powinny zajmować się czyszczeniem ani konserwacją urządzenia bez odpowiedniego nadzoru.

- Przechowywać opakowanie w miejscu niedostępnym dla dzieci lub zutylizować je w odpowiedni sposób.

1.2 Ogólne zasady bezpieczeństwa

- Urządzenie to przeznaczone jest wyłącznie do przechowywania żywności i napojów.
- Urządzenie to przeznaczone jest do użytku domowego w pomieszczeniach zamkniętych.
- Urządzenie to można używać w biurach, pokojach hotelowych, pokojach w pensjonatach, domach dla gości w gospodarstwach rolnych i innych podobnych miejscach, gdzie użytkowanie nie przekracza średniego poziomu użytkowania w gospodarstwie domowym.
- Aby uniknąć zanieczyszczenia żywności, należy przestrzegać następujących zaleceń:
 - nie pozostawiać zbyt długo otworzonych drzwi;
